



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 74/16
Prishtinë, më 21.12.2016, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë deputetët: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Sali Morina, Bali Muharremaj, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontić dhe Bardhyl Meta.

Pjesëmarrës të ftuar: Ismet Krasniqi – Sekretar i Përhershëm i Administratës së Kuvendit të Kosovës, Emrush Haxhiu- Drejtori i Drejtorës së Përgjithshme të Administratës në KK, Istret Azemi - Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Pagesa në KK, Hasan Isufaj- ekspert i financave publik, Pranvera Dobruna – praktikante, Albulena Nuha- Gazetare RTV 21, Valdete Berisha – Gazetare nga Info, Albulena Mavraj- Gazetare – Epoka e Re, Senada Halimi – Zëri Syzana Bujupi- gazetare nga Rrokum TV.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjet e mbajtura të Komisionit dt. 9.11.2016 dhe 23.11.2016.**
- 3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmuorin e viti 2016.**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsime, shkencë e teknologji, Kulturë Rini e Sport.**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr 05/L-89 për Tregtinë dhe produktet e Naftës dhe Karburante të Ripërtitshme në Kosovë dhe Amendamenteve të Komisionet funksional për Zhvillim për Ekonomik Infrastruktura, Tregti dhe Industri.**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari- theksojë se në të ndryshme do të propozojë që formalisht të votojmë Raportin me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike, dhe të procedojë që të radhitet për shqyrtim në seancën e nesërm plenare, si pikë shtesë.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjet e mbajtura të Komisionit dt. 9.11.2016, dhe 23.11.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbalet miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2016

Ismet Krasniqi - theksoi se të dhënat për nëntmujorin e vitit 2016, tregojnë shpenzimet sipas kategorive në vijim: pagat e mëditjet janë shpenzuar 100% nga ajo që është planifikuar, mallrat dhe shërbimet 74,71%, shpenzimet komunale 66.52%, subvencione dhe transfere 66.52%, dhe shpenzime kapitale 40.35%. Në total shpenzimin i buxhetit nga ajo që është planifikuar është 84.71%, ndërsa sipas gjendjes aktuale që e kemi nxjerr dje, shpenzimet kalojnë 90%.

Kryetari - sa i përket shpenzimeve të biletave të udhëtimit, kemi 35,278 euro më shumë krahasuar me vitin e kaluar, për akomodimet zyrtare 41,287 euro më shumë, shpenzimet tjerat të udhëtimit zyrtar jashtë vendit 25,347 euro më shumë, telefonua roaming me mbushje është 22,000 euro me shumë, paisje të tjera nënvlërën e 1,000 euro 82,530 euro me të mëdha se periudha paraprake, dreka zyrtare 39,458 euro dhe gjithsejt për mallra dhe shërbime shpenzimet janë për 398,395 euro më të mëdha se në periudhën paraprake të vitit të kaluar.

Ismet Krasniqi – sqaroi se me vetë faktin rritjes së numrit të biletave ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve. Shpenzimet për akomodim dhe shpenzimet tjera jashtë vendit janë si rezultat i asaj që për dallim nga vitet e kaluar ku kemi pasur mbështetje të donatorëve, këtë vit pothuajse të gjitha shpenzimet e jashtë vendit janë mbuluar nga Kuvendi. Tek shpenzimet e drekave zyrtare janë si rezultat i shpenzimeve për mysafirët që ka pritur Kuvendi, si rasti i takimit në kuadër të MSA-së, vizitat e eurodeputetëve, mbajtja e samitit të Asamblesë Parlamentare e NATO-së, përfshirë këtu shpenzimet për akomodim dhe lëvizje e përcjellje. Çdo shpenzim është i përmbyllur me vendimin përkatës.

Istret Azemi – sa i përket shpenzimeve “paisjet tjera”, kjo si rezulta i renovimit të objektit ku është dashur të ndërrohet komplet alarmi i zjarrit që ka kushtuar rreth 54,000 euro, po ashtu këtë vit janë blerë 30,000 euro paisje tjera si printera, telefona, UPS, kufje e pasisje tjera të ngjashme. Vitin e kaluar këto shpenzime nuk kanë mundur të bëhen për shkak të procedurave të prokurimit

Besa Gaxherri - theksoi se shpenzimet për mallra dhe shërbime, në dreka e darka janë shumë të mëdha dhe çdo vit ka me pasur rritje të këtyre shpenzimeve, por ajo që na intereson është me ditë striktë se kush i bënë këto shpenzime? Nga analiza e raportit, ju keni realizuar buxhetin 84.71%. Përveç për paga dhe mëditje që janë 100%, shpenzimet tjera nuk janë realizuar në masën e planifikuar. Prandaj, kur të bëhen planifikimet duhet me qenë striktë sa ka nevojë të harxhohen dhe aq të ndahet buxheti. Për shpenzimet kapitale të na tregoni në mënyrë më detale si janë shpenzuar dhe si është gjendja aktuale?

Ismet Krasniqi – sa i përket shpenzimeve kapitale, periudha e tremujorit të parë të vitit zakonisht përfshinë zakonisht shpalljen e procedurave të tenderit dhe kur kemi ndonjë ankesë tek vlerat e mëdha, merr kohë 40 ditë dhe kjo po ndikon në realizimin e këtyre shpenzimeve në këtë fazë. Por unë po themë se shpenzimet kapitale në bazë të planifikimit do të arrijnë deri në 93.50% deri në fund të vitit. Sa i përket shpenzimeve komunale ne aplikojmë edhe ngrohtoren e qytetit edhe naftën që e blejmë. Tek subvencionet dhe transferet shpenzimet bëhen në bazë të vendimeve të Kryesisë. Një pozicion është një projekt i përbashkët me USAID-in për ta ndihmuar Kuvendin, ku Kuvendi participon me 20,000 euro, ndërsa USAID me 300,000 dollar që nuk është prezantuar në këtë tremujor. Në raportin final, mendojë që të gjitha kategoritë do ta kalojnë 90%.

Shqipe Pantina - shqetësimi im kryesorë është për kategorinë subvencione dhe transfere. Për mendimin tim është krejtësisht e panevojshme që këto shpenzime me qenë në kuadër të Kuvendit sepse Kuvendi nuk është institucioni që jep subvencione, pamarrë parasysh fushat që janë dhënë këto subvencione dhe këto janë përgjegjësi e qeverisë dhe e ministrive të linjes. Nga të dhënat e prezantuar për mënyrën e ndarjes së subvencioneve, shohim se ato i janë ndarë disa organizatave qeveritare, siç është rasti me Këshillin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për me i mbikëqyrë realizimin e institucioneve korrektuese, qendrat për parandalim dhe paraburgim, që për mendimin tim këto mjete është dashur të bëhen nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë ose Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Një rast tjetër është një vendim për ndërtimin e busteve, për këtë qështje duhet të merret Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.

Shqetësimi i dytë, ka të bëjë me buxhetin e komisioneve parlamentare, që është shpenzuar shumë pak. Pse ndodh kjo, a është si pasojë që nuk jemi duke e kryer punën apo nuk jemi duke i planifikuar mirë këto shpenzime? Kam një pyetje, për shpenzimet për karburant të veturave zyrtare. Nëse i krahasojmë shpenzimet sipas shfrytëzuesve, shohim dallime të mëdha. Përderisa një anëtar i Kryesisë i ka shpenzuar 4.74% siç është rasti i Aida Dërgutit, stafi i kabinitet ka shpenzuar 11.54%. Duhet me ditë pse ky dallim kaq i madhë, a janë keqërdorur apo ka dikush veturë më lluksoze? Një qështje tjetër që duhet ta trajtojmë janë mbushjet e telefonit të deputetëve që mendoj se duhet të ndryshojë, ndoshta të aplikohet forma e faturimit.

Ismet Krasniqi – shpenzimet për KMLDNJ-në janë si rezultat i një Memorandumi të Bashkupunimit ku si rezultat të gjitha vizitat që i bënë ky Këshill i adresojnë informatat Komisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione. Çështja e ngritjes së busteve apo edhe në total e subvencioneve dhe adresimi i këtyre shpenzimeve bëhet në bazë të Rregullores dhe një nen ku thotë se kur Kuvendi është përfitues në bazë të një marrëveshje, mundet me nda subvencione. Sa i përket shpenzimeve të buxhetit për komisionet, ekziston Udhëzimi për mënyrën e shpenzimit të tyre dhe në bazë të marrëveshjes së Kryesisë, 5,000 euro janë të ndara për komisionet funksionale dhe 10,000 euro për komisionet e përhershme. Sa i përket shpenzimeve për vetura ne kemi një sistem apo databazës dhe jemi i vetmi institucion apo organizatë buxhetore që i sjellim të dhënat detale për shpenzimet për veturat dhe personin që përdor veturat dhe kilometrat e shpenzuara. Një ndër asyet e shpenzimeve për veturat është edhe fakti se disa vetura janë që nga 2001 dhe kushtojnë edhe për mirëmbajtje. Shpenzimet për telefoni, siç jemi në dijeni, për shkak të aplikacioneve falas si viber, po bien çmimet, por nëse ju kërkoni ne mund ta diskutojmë apo edhe shkurtojmë.

Shukri Buja – vlersësojë se janë përgaditur mirë pasqyrat e buxhetit me informata të plota. Shpenzimet për nëntëmujorin janë problematikë për të gjitha organizatat buxhetore, por mendojë se është dashur të jenë më të larta. Ndërsa tek kategoria e investimeve kapitale është një problematikë e gjitha organizatave buxhetore si rezultat i procedurave të prokurimit dhe përqindja rritet në fund të vitit dhe këtu duhet të jemi të kujdeshëm edhe pse këtë vit është rritur performanca e shpenzimeve. Sa i përket shpenzimeve të akomodimit dhe udhëtimit, ato që janë të shënuar në emër të Valon Xhaferit, prej tre muaj i ka

shpenzuar përmes kartelës 17,685 euro, a janë shpenzime që i ka bërë vetëm apo përfshihen edhe shpenzimet për stafin e kabinetit dhe ato të Kryetarit të Kuvendit?

Ismet Krasniqi – siç e dini Kryetari i Kuvendit, anëtarët e Kryesisë dhe sekretari i Kuvendit kemi kartelë dhe janë të deponuar mjetet që shfrytëzohen jashtë vendit. Sa i përket shpenzimeve për Valon Xhaverin, ndoshta është një lëshim i administratës, që është dashur me një fusnotë të tregohen më në detale se për çfarë janë bërë shpenzimet me kartelë, pasi që është ngarkuar zyrtari apo këshilltari me kartelën apo shpenzimet dhe nuk është dhënë sqarimi për përmbajtjen e shpenzimeve dhe për personat që janë bërë ato shpenzime.

Sali Morina - tek kategoria subvencione çdo institucion në nivel të qeverisë ka një rregullore të brendshme, po më intereson me ditë Kuvendi a ka rregullore të brendshme për këtë kategori. Nëse ka, si është rregulluar qështja e shpenzimeve të mjeteve për subvencione, u përmenden disa organizatat joqeveritare që janë mbështetur, pyejta është a vendos vet Kryetari i Kuvendit për ndarjen e këtyre mjeteve apo ekziston ndonjë komision që vendos për shpenzimet e mjeteve për shumat nën 1,000 euro?

Enver Hoti – sa i përket qështjes së subvencioneve, pajtohem me kolegun Salih, që duhe të shikohet Rregullorja për të parë se si shpërndahen dhe ku shkojnë ato. Sa i përket shpenzimeve jashtë vendit dhe shërbimet e arsimit dhe trajnimit, mirëmbajta e ndërtesës, dreka zyrtare krahasuar me periudhën e njëjtë të raportimit në mes vitit 2015 dhe 2016 ka një diferencë rreth 400,000 euro, cilat janë arsyet?

Ismet Krasniqi – sa i përket mënyrës së shpenzimeve të subvencioneve të Kuvendit, ekziston një Rregullore e miratuar nga Kryesia e Kuvendit. Ne si administratë jemi me përgadit dhe prezantue raportin dhe shpenzimeve që janë bërë, bazuar në vendimet përkatëse. Sa i përket krahasimeve në mes vitit 2015-2016 të periudhës raportuese është për shkak se në vitin 2015 ka pasur më pak aktivitete se në vitin 2015. Psh. rasti i shpenzimeve të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, më herët kemi pasur partnerët si GIZ, NDI dhe USAID që i kanë mbuluar disa shpenzimeve të tilla, ndërsa 2016 kryesisht janë mbuluar me buxhet të Kuvendit. Me vet faktin që po rritet prezenta e Kosovës në mekanizma jashtë vendit, në konferenca dhe në delagacione të përhershme, nënkupton që shumë më shumë shpenzime kemi me pas tani jashtë vendit. E përmeda rastin e shpenzimeve të takimit të asamblesë së NATO-së në Kosovë që nuk ka mundur të kalkulohen shpenzimet në detale.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, një Kundër dhe dy Abstenime, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin e shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2016.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Arsim, Shkencë e Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Kryetari – projektligji dhe amendamentet nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-075 për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive dhe amendamentet e Komisionit funksional për Arsim, Shkencë e Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-89 për Tregtinë dhe produktet e Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme në Kosovë dhe Amendamenteve të Komisionet funksional për Zhvillim për Ekonomik Infrastruktura, Tregti dhe Industri.

Kryetari - projektligji dhe amendamentet nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Kryetari konstatoi se Komisioni me nëntë vota Për, ansjë Kundër dhe një Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

Projektligji Nr.05/L-89 për Tregtinë dhe produktet e Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme në Kosovë dhe Amendamenteve të Komisionet funksional për Zhvillim për Ekonomik Infrastruktura, Tregti dhe Industri, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Të ndryshme

Kryetari – theksoi se Projektligji nr. 05/L–119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike ka kaluar të gjitha procedurat dhe raporti final me rekomandime është i gatshëm për procedim dhe shqyrtim të dytë në Kuvend. Propozojë që të miratojmë raportin dhe rekomandojë që të futet për shqyrtim si pikë shtesë, në seancën plenare të datës së nesërm dt. 22.12.2016.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht, nxori këtë

Rekomandim

Komisioni miratojë Raportin final me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L–119 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr.05/L-043 për Faljen e Borxheve Publike dhe rekomandon që Projektligji me amendamentet e propozuara të radhitet për shqyrtim të dytë, si pikë shtesë në seancën plenare të datës 22.12.2016.

Mbledhja përfundoi në ora 13:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani